




REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Prilijeno/Prodato Received / Delivery	20. 01 2021	1	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jedinstvo Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
<i>[Signature]</i>	237/2021		114



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.412/2020

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Kolegji për shqyrtimin e ankesave i përbërë nga: Malsore Gashi-Bajraktari - kryetare, Jeton Koca dhe Eshref Shabani -anëtar, si dhe Ardita Perçuku-Shyti, Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtëses kane shqyrtuar ankesën me numër A.nr.412/2020, të datës 11.12.2020, të ankueses me adrese banimi rr. “Sami Frashëri”, nr.34, nga Komuna e Prishtinës, kundër organit të punësimit Ministria e Infrastrukturës, në çështjen juridike “kërkesë nga marrëdhënia e punës”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1.1 nen paragrafin 1.1, nenin 16 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregullores Nr. 03/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës në seancën për këshillim dhe votim me datë 19.01.2021, mori këtë;

V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa me numër A.nr.412/2020 e datës 11.12.2020, e parashtruar nga ankuesja

A r s y e t i m

Ankuesja ka qenë e punësuar në Ministrinë e Infrastrukturës, sipas Kontratës për Marrëveshje për Shërbime të Veçanta nga data 01.04.2016 deri me 29.12.2020 në pozitën „Zyrtare financiare” në Departamentin e Menaxhimit të Rrugëve në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Ambientit.

Ankuesja pas miratimit të Ligjit nr. 06/L –114 për Zyrtarët Publikë, në pajtim me Ligjin Nr.06/L-048, për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ka parashtruar ankese përmes Postes së Kosovës, me datën 09.12.2020, ndërsa në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, është pranuar me datën 11.12.2020, me pretendimet ankimore se pas miratimit të Ligjit nr. 06/L – 114 për Zyrtarët Publikë nuk i është vazhduar kontrata e punës që Këshilli të nxjerr vendim për themelimin e rregullt të marrëdhënies së punës sipas shërbimit civil, si dhe ti njihet statusi si nëpunës civil.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, me datë 17.12.2020 me numër protokollit 3184/2020 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankese tek Ministria e Infrastrukturës, ndërsa me datën 18.12.2020 me numër protokollit 3199/2020, Këshilli ka pranuar përgjigje në ankese nga Ministria e Infrastrukturës, me shkresat e bashkangjitura.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me numër A.nr.412/2020, e datës 11.12.2020, drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kontrate e ankueses për marrëveshje për shërbime të veçanta e datës 01.04.2016; Kontrate e ankueses për marrëveshje për shërbime të veçanta e datës 01.07.2016; Kontrate e ankueses për marrëveshje për

shërbime te veçanta e datës 04.01.2017; Kontrate e ankueses për marrëveshje për shërbime te veçanta e datës 03.03.2017; Kontrate e ankueses për marrëveshje për shërbime te veçanta e datës 02.05.2017; Kontrate e ankueses për marrëveshje për shërbime te veçanta e datës 04.09.2017; Kontrate e ankueses për marrëveshje për shërbime te veçanta e datës 01.12.2017; Kontrate e ankueses për marrëveshje për shërbime te veçanta e datës 03.01.2018; Kontrate e ankueses për marrëveshje për shërbime te veçanta e datës 01.07.2018; Kontrate e ankueses për marrëveshje për shërbime te veçanta e datës 01.01.2019; Kontrate e ankueses për marrëveshje për shërbime te veçanta e datës 17.07.2019; Kontrate e ankueses për marrëveshje për shërbime te veçanta e datës 31.12.2019; Kontrate e ankueses për marrëveshje për shërbime te veçanta e datës 06.01.2020; Kontrate e ankueses për marrëveshje për shërbime te veçanta e datës 01.07.2020; Vërtetim i marrëdhënies se punës i datës 29.12.2020; Kërkesë e datës 16.08.2018 për nënshkrimin e kontratës; Rekomandim për vazhdimin e kontratës i datës 05.06.2020; Plani individual për caktimin e detyrave për gjashtë mujorin e pare qershor-dhjetor te vitit 2016; Kërkesë e datës 16.10.2020 e ankueses; Dëshmi mbi pagesën e trustit për ankuesen për periudhën prej 01.08.2002-09.10.2020; Përgjigje ne kërkesë nga Ministria e Infrastrukturës për ankuesen e datës 22.10.2020; E-maili zyrtar i datës 17.11.2020; Kërkesë për deklarin e statusit te nëpunësit publik e datës 20.10.2020; Letër reference për ankuesen; Kërkesa për përgjigje ne ankese e datës 17.12.2020; Përgjigja ne ankese e datës 18.12.2020 me shkresat e bashkangjitura.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës, ka konstatuar se ankesa e ankueses *është e pa bazuar* sepse:

Kolegji ka analizuar pretendimet ankimore te ankueses, e cila pretendon se ka qene e angazhuar ne Ministrinë e Infrastrukturës për më shumë se 4 vite në pozitën “Zyrtare e financave”, pranë Departamentit për Menaxhimin e rrugëve, ku kjo pozitë është e lirë dhe kërkon ti njihet statusi i nëpunësit civil.

Pas analizimit dhe shqyrtimit te shkresave te lendes, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka konstatuar se: ankuesja ka krijuar marrëdhënie kontraktuale (si kryesi i shërbimeve) me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Transportit si (ofruer i shërbimit), për kryerje te shërbimeve te veçanta nga fusha e detyrave dhe përgjegjësiive ne Departamentin e menaxhimit te rrugëve, respektivisht për ofrimin e shërbimeve ne pozitën “Zyrtare financiare”. Ankuesja fillimisht ka lidhur marrëveshjen baze për shërbime te veçanta me datën 01.04.2016 deri me 01.07.2016, pastaj ka vazhduar me tej me marrëveshje tjera për

shërbime te veçanta me kohëzgjatje prej 6 muajsh pa proces të rekrutimit. Marrëveshja e fundit për shërbime të veçanta është lidhur me datën 01.07.2020 deri me datën 17.11.2020, kur edhe ankuesja ka pranuar njoftimin me e-mail prej Udhëheqësit të saj të drejtpërdrejtë ku thuhet se: “Ne bazë të Sekretarit të Përgjithshëm, jemi te obliguar t’ju njoftojmë të gjithë nëpunësve të cilët janë me marrëveshje për shërbime të veçanta në Departamentin e Menaxhimit të Rrugëve, se në bazë të Ligjit Nr.06/L-114, nuk do të ju vazhdohen kontratat për shërbime te veçanta”.

Me datën 05.06.2020, Udhëheqësi i drejtpërdrejte i ankueses nga Departamenti i Menaxhimit të rrugëve, i ‘u është drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Infrastrukturës, me rekomandim për vazhdimin e kontratës së punës për ankuesen *ne arsyetimin se ankueses i përfundon* kontrata me datën 30.06.2020 dhe ka vlerësuar se është e nevojshme ti vazhdohet kontrata pasi që ka mungesë të stafit në këtë departament, duke i marrë për bazë profesionalizmin dhe përkushtimin e saj dhe rezultatet e mira që ka treguar në punë gjer tek plotësimi i pozitës me konkurs. Ankuesja me datën 20.10.2020,ka ushtruar kërkesë për deklarin e statusit të nëpunësit publik, në Departamentin për Menaxhimin e zyrtarëve publik-DMZP në Ministrinë e Punëve të Brendshme. Nga shkresat lëndës, Kolegji ka gjetur se me datën 22.10.2020, Ministria e Punëve te Brendshëm konkretisht Departamenti për menaxhimin e zyrtarëve publik e ka njoftuar se me këtë kërkesë është dashur qe institucioni ku

10/10/2020
10/10/2020
10/10/2020

punoni ti drejtoheni, por meqenëse kjo nuk ka ndodhur, atëherë e ka njoftuar si në vijim : “në bazë të argumenteve të ofruara në kërkesën tuaj të lartpërmendur, ju sqaroni se për tërë kohën sa keni qenë e angazhuar në punë në Ministrinë e Infrastrukturës, nuk keni pasur një kontratë të rregullt pune si zyrtare e financave por keni kryer punë me marrëveshje për shërbime të veçanta që nga muaji prill i vitit 2016, fakt ky që nuk i ‘u ka mundësuar, që ju të keni statusin e nëpunësit civil duke ju referuar nenit 84 të Ligjit nr.06/L-114 për zyrtarët publik”. Kolegji ka konstatuar se nga shkresat e lëndës të dërguara nga Ministria e Infrastrukturës, nuk kemi dëshmi se ankuesja është vlerësuar nga udhëheqësi i drejtpërdrejtë i saj, ndërkaq sa i përket pozitës “Zyrtare financiare” kjo ministri ka deklaruar se kjo pozitë është e lirë.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar se Ligji për Zyrtarët Publik përkatësisht neni 83 paragrafi 2 ka përcaktuar se :**“2.Një punonjës aktual, që nuk e ka statusin e nëpunësit civil sipas Ligjit të Shërbimit Civil (03/L-149), por që e mbanë një pozitë, e cila është pozitë e shërbimit civil për nga funksionet dhe përgjegjësitë sipas nenit 2 paragrafit 3 të këtij ligji, do të merohet si nëpunës civil sipas këtij ligji, nëse i plotëson këto kushte: 2.1.ka qenë në marrëdhënie pune në një institucion të administratës shtetërore apo në një institucion tjetër shtetëror së paku dy vjetët e fundit para hyrjes në fuqi të këtij ligji; 2.2. i plotëson kërkesat e nenit 8 të këtij ligji dhe 2.3.është vlerësuar për rezultatet në punë në këto dy vjet të paktën “mirë”.** Në kuptim të këtyre dispozitave ligjore, Kolegji vlerëson se për deklaram të statusit të nëpunësit civil të një nëpunësi i cili nuk e ka statusin e Shërbyesit Civil sipas ligjit të shfuqizuar për Shërbimin Civil Nr.03/L-149, kërkohet që nëpunësi në fjalë të ketë krijuar një marrëdhënie pune sipas një akti të rregullt juridik respektivisht të ketë përgjegjësitë bazuar në Ligjin për Zyrtaret Publike, konsiderohet pozitë e shërbimit civil, marrëdhënia e punës të jetë krijuar së paku dy vjet para datës së hyrjes në fuqi të Ligjit për Zyrtaret Publik si dhe të jetë krijuar së paku dy vjet para datës së hyrjes në fuqi të Ligjit për Zyrtaret Publik si dhe të jenë plotësuar kushtet e përgjithshme dhe të veçanta të përcaktuara me nenin 8 të Ligjit për Zyrtaret Publik, i cili parasheh **“ Kërkesat e përgjithshme për pranimin e zyrtareve publike janë:1.1. të jete shtetas i Republikës së Kosovës; 1.2. të ketë zotësi të plote për të vepruar; 1.3. të zotëroj njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për gjuhët; 1.4. të jetë i aftë në pikëpamje shëndetësore për të kryer detyrën përkatëse; 1.5. të mos jete i dënuar me vendim të formës së prere për kryerjen e një vepre penale me dashje; 1.6. të mos ketë në fuqi një mase disiplinore për largim nga një pozitë e zyrtarit publik, të pushuar sipas këtij ligji”** si dhe nëpunësi duhet të ketë rezultate të mira të punës, të pushuar sipas këtij ligji. **2. Përveç kushteve që parashikohen në paragrafin 1 të këtij neni, kandidatet për t’u pranuar si nëpunës civil, nëpunës të Shërbimit Publik dhe nëpunës administrativ dhe mbështetës, duhet t’i plotësojnë edhe këto kërkesa: 2.1. të kenë nivelin e arsimit dhe përvojën e punës të kërkuar për pozitën, kategorinë, klasën apo grupin përkatës dhe 2.2. të kalojnë me sukses procedurat e fundit”.** Andaj, mbështetur në këtë konstatim si dhe bazuar në shkresat e lëndës, Kolegji konstaton se ankuesja nuk ka krijuar një marrëdhënie juridike-administrative me Ministrinë e Infrastrukturës, por një marrëdhënie kontraktuale me qëllim të kryerjes së shërbimeve të caktuara për një periudhë të caktuar kohore, ashtu siç parashihej me nenin 12 paragrafi 4 të Ligjit të shfuqizuar Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil , ku thuhej : **“Emërimet me afat të caktuar për një periudhë me të shkurtër se gjashtë (6) muaj do të behën në baze të kontratave të quajtura “Marrëveshje për shërbime të veçanta” të cilat i nënshtrohen Ligjit për Detyrimet dhe për të cilat zbatohet një procedure e thjeshtësuar e rekrutimit”.**

Gjithashtu bazuar në nenin 84, paragrafin 1 të Ligjit NR.06/L-114 për Zyrtaret Publike, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar se marrëveshjet për shërbime të veçanta të lidhura para hyrjes në fuqi të këtij ligji, do të jene të vlefshme vetëm deri në aftin e përcaktuar në këto marrëveshje ku citojmë **“Marrëveshjet për Shërbime të Veçanta, sipas paragrafit 4 të nenit 12 të Ligjit për Shërbimin Civil Nr.03/L-149 të Republikës së Kosovës, të lidhura para hyrjes në fuqi të këtij ligji, janë të vlefshme deri në afatin e përcaktuar në ato marrëveshje në pajtim me dispozitat e lartcekura. Pas kësaj periudhe, Marrëveshjet për Shërbimet e Veçanta lidhen sipas legjislacionit përkatës të Prokurimit Publik”,** prandaj mbi bazën e kësaj edhe pretendimet ankimore të ankueses janë të pa




bazuara, sepse nga shkresat e lendes del se ankuesja kontratën për marrëveshje për Shërbime të Veçanta e ka lidhur në kohëzgjatje prej datës 01.04.2016 deri me datën 01.07.2020 (kontrata e fundit).

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin e ankesës, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda A.nr.412/2020

Ardita Perçuku-Shyti


Zyrtare e lartë për Bashkëpunim Profesional

Malsore Gashi-BAJRAKTARI


Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankueses
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Infrastrukturës;
- Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Infrastrukturës;
- Arkivit të KPMSHCK-së

